

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje dhe instalim i sistemit të ftohjes në vendruajtjet e AQSHF-së”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP)**

Sisteme që furnizohen me gaz 42113390-4, Sisteme ftohjeje me gaz 31161200-4, Kompresor 31158200-0, Ventilatorë 39714100-1, Azot 24111700-2

**VLERA E FONDIT LIMIT I KONTRATËS: 4,138,486 (katër milion e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, ndërsa nga ana e grupit të punës të ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Arkiva Qendrore Shtetërore e Filmit janë hartuar specifikimet teknike me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik të ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës

te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përllëgoaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.”

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.*

**2.3.2** Operatori Ekonomik për kryerjen e shërbimit të instalimit/montimit të artikujve objekt prokurimi duhet të ketë të punësuar stafin e tij teknik si më poshtë:

- Të paktën **1 (një) Inxhinier mekanik** i profilizuar (në sisteme të kondicionimit të ajrit, ngrohje-ftohje);

-Të paktën **2 (dy) Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse;**

Operatori ekonomik në lidhje me stafin teknik të kërkuar më sipër duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

### Për inxhinierin mekanik

- Kontratë pune të vlefshme;
- CV
- Diplomë

- Listpagesat e shoqërisë minimumi muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave

Për Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse;

- Kontratë pune të vlefshme ose kontratë bashkëpunimi;  
CV
- Çertifikatë/Diplomë/Dëshmi kualifikimi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

**Shënim:** Kriteri Nr.2.3.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në bazë të nenit të 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Vendimi 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar” dhe Urdhërit nr.99, datë 25.05.2021 “Për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Punonjësit e sipërpërmendur kërkohen në përputhje të plotë me objektin e prokurimit. Vendosja e inxhinierit mekanik dhe instaluesve siguron që procesi i montimit dhe riparimit të pajisjeve të kryhet me standarde të larta profesionale. Kualifikimet dhe eksperiencia e stafit teknik minimizojnë rrezikun e problemeve teknike në pajisje pas instalimit. Kërkimi i diplomave dhe certifikatave garantojnë kualifikimin e personelit të angazhuar në këtë proces. Stafit teknik i kualifikuar sjell efikasitet në procesin e instalimit dhe mirëmbajtjes, duke kursyer kohë dhe burime, si dhe duke shmangur ndërprerjet e mundshme në funksionimin e pajisjeve. Inxhinieri mekanik është i rëndësishëm për të mbikëqyrur dhe siguruar instalimin korrekt të pajisjeve dhe do të shërbejë si drejtues teknik për organizimin, mbikëqyrjen, koordinimin dhe testimin e punimeve të instalimit të sistemit të ftohjes. Kjo redukton çdo rrezik që mund të vijë nga instalime jo të sakta. Dy instalues dhe një inxhinier mekanik në raport edhe me kohën e dorëzimit dhe kryerjes së montimit janë mëse të domosdoshëm për të punuar në mënyrë efektive në realizimin me sukses të kontratës. Dy instaluesit dhe riparuesit e kondicionereve dhe sistemeve ftohëse ngrohëse do të kryejnë instalimin e pajisjeve, linjave frigoriferike, tubacioneve, lidhjeve dhe vënien në funksionim të sistemit. Lidhur me kërkesën për instaluesit e kondicionerëve AK jo domosdoshmërisht kërkon që instaluesit të jenë staf i qëndrueshëm i ofertuesit të mundshëm ekonomik por mund të kontraktohen nga operatorët ekonomikë të interesuar për realizimin e objektit të prokurimit. Ky përcaktim në këtë mënyrë është bërë duke mbajtur parasysh parimet dhe vetë qëllimin e ligjit të prokurimit sikundër janë nxitja e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitja e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë siguri i një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të

*gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; si edhe sigurimi i integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.*

*Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë dhe ti provojnë Autoritetit Kontraktor se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën me sukses.*

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë **katalogë / broshurë / skedë teknike** të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi me Nr rendor 1 “Kompresor” dhe Nr rendor 2 “Kondensues”, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve / broshurave / skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qendror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

*Kjo kerkese ka disa avantazhe pasi permbushja e saj siguron besueshmëri te informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Garanton gjithashtu përputhshmërinë me specifikimet teknike ç'ka siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Kërkesa për përmbushjen e këtij kriteri gjithashtu redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara. Kërkesa pikërisht për katalog për artikujt me nr rendor 1 dhe Nr rendor 2 është bërë për shkak të vlerës dhe rëndësisë që kanë këto pajisje në sistem. Kompresori është një nga komponentët kryesorë të këtij sistemi pasi siguron qarkullimin dhe ngjeshjen e gazit ftohës dhe lidhet drejtpërdrejt me kapacitetin e ftohjes dhe konsumin. Ndërsa përsa i përket kondensuesit edhe ky artikull ka një rol të rëndësishëm sepse largon nxehtësinë nga gazi ftohës dhe e kthen atë në gjendje të lëngshme pra përcakton sa mirë sistemi largon nxehtësinë dhe të dy bashkë ndikojnë në kapacitetin real, eficientë dhe jetgjatësinë.*

*Për sa më sipër, përmes përmbushjes së kësaj kërkesë, AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog/broshurë/skede teknike do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.*

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent** (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Këto kritere janë vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuara se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat

*e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nganjë organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar me mall cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.*

*ISO 9001:2015 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. ( e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë ). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s'kualifikim.**

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

**Specifikimet teknike të posaçme për artikujt e kërkuar nga autoriteti kontraktor përfitues:**

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MATERIALEVE DHE PAJISJEVE**

| <b>Nr.</b> | <b>Pajisja /<br/>Materiali (Sipas<br/>unnamed.jpg)</b> | <b>Specifikimet Teknike</b>                                                                                                                                                                                                      |
|------------|--------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1</b>   | <b>Kompresor<br/>21kw</b>                              | Kompresor hermetik ose gjysmë-hermetik për sisteme ftohjeje industriale, me kapacitet ftohës minimal 21 kW. Të jetë me eficiencë të lartë energjetike (klasa A+ ose e barasvlershme), me mbrojtje termike të integruar, nivel të |

| Nr. | Pajisja /<br>Materiali (Sipas<br>unnamed.jpg) | Specifikimet Teknike                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|-----|-----------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|     |                                               | ulët zhurme dhe dridhjeje sipas standardit <b>SSH EN IEC 60335-2-34:2023/A12:2025</b> . Të jetë i përputhshëm me gaz ekologjik për temperatura të ulta 2 gradë deri 7 gradë celcius                                                                                                                                                                                                         |
| 2   | <b>Kondensues<br/>29.6kw</b>                  | Kondensues me ajrim të detyruar (ventilatorë aksialë), me kapacitet shkëmbimi termik minimal 29.6 kW. Tubacionet e brendshme të jenë prej bakri me fletë alumini për shpërndarje optimale të nxehtësisë. Struktura e jashtme të jetë e trajtuar kundër korrozionit (galvanizuar/lyer me pluhur elektrostatik) për instalim në ambient të jashtëm, sipas standardit <b>SSH EN 378-1:2016</b> |
| 3   | <b>Ventilator Fan<br/>coili 90w</b>           | Ventilator centrifugal ose aksial për njësi fancoil, me fuqi elektrike nominale 90W. Të ketë të paktën 3 shpejtësi rrotullimi, motor elektrik me induksion me mbrojtje nga mbingarkesa termike (Klasa e izolimit B ose F), dhe shkallë mbrojtjeje minimale IP44 sipas <b>SSH EN 60529:1991/A2:2013</b>                                                                                      |
| 4   | <b>Gaz ftohës, për<br/>temp të ulta</b>       | Gaz ftohës për temperatura të ulta (2°C - 7°C, i certifikuar për përdorim në sisteme ftohjeje komerciale dhe industriale me temperatura të mesme/të ulëta. Të jetë i pastër (pastërti minimale 99% deri në 99.5%), pa përmbajtje klori (ODP=0), i dorëzuar në bombula të siguruara sipas rregullores mjedisore në fuqi në RSH.                                                              |
| 5   | <b>Azot</b>                                   | Azot i lëngshëm/gaztë (N2) industrial me pastërti të lartë, pa lagështi. I destinuar për kryerjen e provave të presionit (testim rrjedhjeje) dhe pastrimin (shplarjen) e linjave të bakrit përpara karikimit me gaz ftohës, sipas rregullave të instalimeve HVAC.                                                                                                                           |

| Nr. | Pajisja /<br>Materiali (Sipas<br>unnamed.jpg) | Specifikimet Teknike                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|-----|-----------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 6   | <b>Automat<br/>diferencial 63A</b>            | Ndërprerës automatik magneto-termik me mbrojtje diferenciale të integruar (RCBO / Automat Diferencial), me rrymë nominale 63A, katërpolar (4P) ose dypolar sipas skemës elektrik. Rryma e rrjedhjes (ndjeshmëria): 30 mA (për mbrojtjen e personelit) ose 300 mA (për mbrojtje nga zjarri). Kapaciteti minimal i prishjes: <b>6 kA</b> ose <b>10 kA</b> sipas standardit <b>SSH EN 60947-2:2017</b>                |
| 7   | <b>Kanaline</b>                               | <p>Kanalizim plastik (PVC) vetëshuajës për mbrojtjen dhe kalimin e kablllove elektrike dhe të sinjalit. Të jetë rezistente ndaj goditjeve mekanike (klasa minimale <b>IK07</b> ose <b>IK08</b>) dhe me shkallë mbrojtjeje ndaj zjarrit sipas standardit <b>SSH EN 50085-2-1:2006</b></p> <p>Të furnizohet së bashku me të gjithë aksesorët (brryla, mbyllje, degëzime).</p>                                        |
| 8   | <b>Panel elektrik<br/>komandimi 32m</b>       | Kuahër/Panel elektrik shpërndarës dhe komandimi prej materiali plastik vetëshuajës ose metalik me lyerje elektrostatische, me kapacitet minimal për 32 module (32M). Shkalla e mbrojtjes ndaj lagështisë dhe pluhurit të jetë minimale <b>IP54</b> ose <b>IP65</b> (për shkak të ambientit me lagështi/ftohje) sipas standardit <b>SSH EN IEC 61439-1:2021</b> . Të përfshijë shinat DIN dhe tokëzimin e rregullt. |
| 9   | <b>Automat Bipolar</b>                        | Ndërprerës automatik magneto-termik dypolar (2P), rryma nominale (psh. 16A ose sipas projektit), Karakteristika e shkarkimit: Tipi C (për ngarkesa induktive/motorike). Kapaciteti minimal i prishjes: <b>6 kA</b> sipas standardit <b>SSH EN 60898-1:2019/A11:2024</b>                                                                                                                                            |



| Nr. | Pajisja /<br>Materiali (Sipas<br>unnamed.jpg) | Specifikimet Teknike                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|-----|-----------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 10  | <b>Salvamotor 63A</b>                         | Ndërprerës mbrojtës magneto-termik specifik për motorët elektrikë (Salvamotor), me fushë rregullimi që mbulon rrymën nominale të kompresorëve, me vlerë maksimale deri në 63A. Të ketë mbrojtje të integruar kundër mbingarkesës, koutit të shkurtër dhe mungesës së njërës fazë (asimetria e fazave) sipas standardit <b>SSH EN IEC 60947-4-1:2019/AC:2020-05</b>      |
| 11  | <b>Kabull 5x10</b>                            | Kabullo elektrike fuqie e përbërë nga 5 përcjellës bakri me prerje tërthore 10 mm <sup>2</sup> secili (përfshirë fazat, neutralin dhe tokëzimin). Izolimi i jashtëm të jetë PVC ose i tipit <b>FG16OR16 / FG7OR</b> (jo-përhapës zjarri, me çlirim të ulët gazrash korrozivë) me tension nominal 0.6/1 kV, sipas standardit <b>SSH EN 50575</b> (Kodi i Ndërtimit CPR). |
| 12  | <b>Kabull unik 5x1 ose ekuivalent</b>         | Kabullo elektrike fleksibël për komandim dhe sinjalistikë (apo furnizim fancoilash), e përbërë nga 5 përcjellës bakri me prerje tërthore 1 mm <sup>2</sup> ose 1.5 mm <sup>2</sup> sipas normës standarde më të afërt). Izolimi i jashtëm i tipit jo-përhapës zjarri dhe vetëshuajës.                                                                                   |
| 13  | <b>Tub bakri</b>                              | Tub bakri pa tegel (seamless) i specifikuar posaçërisht për sisteme ftohjeje dhe klimatizimi (ACR) me diametër të jashtëm nominal 54 mm deri 58 mm. Trashësia e mureve të tubit duhet të garantojë rezistencë ndaj presioneve të larta të punës së gazit. Të dorëzohet i pastruar dhe i mbyllur në skajet e tij. sipas standardit <b>SSH EN 12735-1:2020</b>            |
| 14  | <b>Tub bakri</b>                              | Tub bakri pa tegel për ftohje (ACR), me diametër të jashtëm nominal 20mm deri 22 mm, me mure të përshtatshme për presionin e gazit ftohës në linjat e lëngut ose të thithjes, sipas standardit <b>SSH EN 12735-1:2020</b>                                                                                                                                               |

| Nr. | Pajisja /<br>Materiali (Sipas<br>unnamed.jpg) | Specifikimet Teknike                                                                                                                                                                                                      |
|-----|-----------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 15  | Manikota                                      | Aksesori lidhës i drejtë (manikotë) prej bakri të pastër ( $\geq 99.9\%$ ), me diametër 54 mm, i projektuar për bashkim me saldim (kapilar) me mjet saldimi argjend/bakër, specifik për linjat e ftohjes nën presion.     |
| 16  | Brryla                                        | Aksesori lidhës këndor (brryl 90° ose 45°) prej bakri të pastër për sisteme ftohjeje, me diametër nga 50mm në 54 mm, për bashkim me saldim kapilar, me rreze të rregullt lakimi që nuk pengon qarkullimin e gazit ftohës. |
| 17  | Manikota                                      | Aksesori lidhës i drejtë (manikotë) prej bakri për ftohje, me diametër 22 mm, për bashkim me saldim kapilar,                                                                                                              |

#### 4. Volumi i Punës dhe Kushtet e Realizimit

- **Vlerësimi i Punës (Instalimet):** 480 orë pune të parashikuara për realizimin e plotë të projektit të konvertuara në 27 ditë pune.
- Punimet e instalimit duhet të garantojnë lidhjen e saktë dhe furnizimin e pandërprerë me energji të kompresorëve, fancoilave dhe sensorëve në arkivin e filmit.

##### 4.1 Grafiku i punimeve të instalimit

Grafiku i punimeve do të jetë si më poshtë.

| Faza | Aktiviteti | Kohëzgjatja | Ditët e punës |
|------|------------|-------------|---------------|
|------|------------|-------------|---------------|

1 Organizimi i kantierit, verifikimi, shkarkimi dhe pozicionimi i pajisjeve 1 ditë


2 Vendosja e kompresorëve, fancoilave dhe elementëve mbajtës 5 ditë 2–6

3 Instalimi i linjave frigoriferike, tubacioneve të kondensatit dhe lidhjeve elektrike 12 ditë 7–18

4 Instalimi i sensorëve, automatizimit dhe konfigurimet fillestare 4 ditë 19–22

5 Testimi, vënia në funksionim dhe balancimi i sistemit 2 ditë 23–24

6 Monitorimi i funksionimit, korrigjimi i defekteve eventuale dhe dorëzimi 3 ditë 25–27



## Shënim

- **Fillimi i grafikut kushtëzohet nga data e mbërritjes së pajisjeve.**
- Kohëzgjatja totale e realizimit të instalimit, testimit monitorimit të funksionimit është **27 ditë pune**
- Periudha e testimit dhe monitorimit përfshin kohën e nevojshme për eliminimin e defekteve të mundshme dhe verifikimin e funksionimit të pandërprerë të sistemit përpara marrjes në dorëzim.

Të gjitha pajisjet teknike dhe materialet e furnizuara duhet të jenë të reja, të papërdorura dhe të shoqëruara me certifikatat përkatëse të cilësisë.

Pas përfundimit të instalimeve, do të kryhet testimi i plotë i rrjetit të brendshëm elektrik, i presionit të tubacioneve dhe funksionalitetit të ftohjes përpara pranimit përfundimtar.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

**Argumentimi:** Arkivi i filmit synon të ndërmarrë një ndërhyrje të rëndësishme në infrastrukturën e tij teknike për të garantuar ruajtjen e standardeve optimale të konservimit. Ky projekt përfshin zëvendësimin e plotë të sistemit aktual të ftohjes bashkë me kullat ftohëse, si dhe ndërrimin e rrjetit elektrik të brendshëm për furnizimin me energji të kompresorëve, fancoilave dhe sensorëve të monitorimit.

Specifikimet teknike janë hartuar nga autoriteti kontraktor përfitues për objektin që prokurohet sipas nevojës, duke përcaktuar informacionin minimal të nevojshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

Duke ju referuar nenit 36 autoriteti kontraktor përfitues **Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit**, ka hartuar specifikimet teknike të cilat shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues. Ne hartimin e secifikimeve teknike është pasur në konsideratë:

1. Natyra e mallrave që do të prokurohen,
2. kushtet e përdorimit të tyre,
3. kërkesat për siguri, cilësi dhe qëndrueshmëri.

-Specifikimet teknike synojnë të garantojnë realizimin e një procedure prokurimi transparente, efektive dhe të barabartë, duke mundësuar blerjen e produkteve që përmbushin kërkesat teknike dhe funksionale të AK dhe që garantojnë përdorim të sigurtm cilësor dhe afatgjatë.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**